

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Turistet rrëfjnë natën e frikshme me zjarret; Himarë: Menduam se nuk do të largoheshim dot nga flakët
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/turistet-rrrefejne-naten-e-frikshme-me-zjarret-ne-hima-re-menduam-se-nuk-d-i584078
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 10:49:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 10:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c615b17d95f3b8b4d1597fee391dea32fb72f4c4433353200b4e2a2424d6e05a
TEKSTI	36e89b91f16ba5fef07436e830ae448a7e6d5cb618bd4832f28b96f2c0e2ce4e
PAMJA	4fa5394c3639bd34484cc6ae8ce34666dd44248abd5d92f8b404cd3993cfff33

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c08ac5253fb3a8e46c06cac54f96323443a08f89f4a3a965e8cf3842f2f20fa
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c08ac5253fb3a8e46c06cac54f96323443a08f89f4a3a965e8cf3842f2f20fa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



1 e [A mund ta zgjidhe nje kujdestar i BE-se bllokimin e gjate mbi asetet ruse?Shkaktuan dy zjarre ne Durres, 3 te dyshuar si piromane ne prangaJashari: Nuk kam mendu fundit](#)

Turistet rrëfejnë natën e frikshme me zjarret në Himarë: Menduam se nuk do të largoheshim dot nga flakët



5 Shtator 2026, 12:55Sociale TEMA



Katër turiste që ndodheshin në Himarë gjatë zjarrit të së premtes në mbrëmje kanë treguar momentet e frikës dhe pasigurisë që përjetuan. Në një deklaratë për A2 CNN ato sot shprehen se situata është qetësuar dhe nuk ndihen më të rrezikuara.

Një prej turisteve tha se në kulmin e zjarrit mendoi se nuk do të mund të largohet nga zona, pasi rrugët ishin bllokuar dhe taksitë nuk mund të arrinin deri tek ato. Ajo falënderoi stafin e hotelit dhe zjarrfikësit për mbështetjen dhe profesionalizmin.

Edhe turistet e tjera treguan se u larguan përkohësisht nga hotelet dhe pritën në restorante derisa situata të vihej nën kontroll. Sipas tyre, flakët dukeshin qartë nga kodrat përreth dhe krijuan momente paniku, por ndërhyrja e forcave zjarrfikëse dhe autoriteteve bëri të mundur shmangien e rrezikut.

Megjithëse të tronditura nga ngjarja dhe dëmet e shkaktuara në natyrë, turistet shprehen se sot ndihen të sigurt dhe vijnë pushimet e tyre në Himarë.

“Dje ishte vërtet shumë e frikshme. Në një moment mendova: ‘Si do të largohemi nga këtu?’ U larguam dhe gjetëm një restorant pranë malit, por nuk mund të vazhdonim më tej. U përpoqa të kontaktoja taksitë, por më thanë se rrugët ishin të bllokuara dhe nuk mund të vinin të na merrnin. Aty u frikësova shumë, sepse nuk kishim as makinë me qira dhe asnjë mundësi tjetër për t’u larguar. Sot ndihem e sigurt, sepse kam folur me stafin e hotelit. Dua t’i falënderoj, sepse na bënë të ndiheshim të sigurt. Tani situata duket më e mirë, pasi nuk i shohim më flakët. Jam shumë mirënjohëse edhe për zjarrfikësit. Kanë bërë një punë të jashtëzakonshme. Faleminderit shumë”, tha njëra prej tyre.

“Nuk e mbaj mend saktësisht se kur nisi zjarri dje, por ndodheshim në hostel, jo shumë larg zonës ku kishte rënë zjarri. Ishte e frikshme. Ne qëndruam në hostel. Sot në mëngjes pamë avionët dhe gjithë ndërhyrjen që po bëhej, ndaj ende nuk dukej plotësisht e sigurt. Por tani mendoj se situata është më e mirë”, u shpreh një tjetër.

“Hosteli ynë ndodhet pak më lart, në kodër, ndaj mund ta shihnim shumë qartë zjarrin. Ishte vërtet e frikshme. Shumë nga personat që qëndronin në hostelin tonë ishin nga Australia dhe, duke qenë se kishin parë situatën tilla edhe më parë, na thanë se duhej të largoheshim. U larguam me makinë dhe qëndruam për pak kohë në një restorant, ku pimë diçka dhe pritëm. Kur nga hosteli na njoftuan se mund të ktheheshim, u rikthyem dhe kaluam natën aty. Sot ndihem e sigurt. Më trishton fakti që ndodhin ngjarje të tilla dhe që zjarret shkatërrojnë natyrën. Megjithatë, këtu është shumë bukur. Kemi kaluar shumë mirë dhe kjo është dita jonë e tretë”, vijon një tjetër.

“Po qëndronim në një hostel lart në kodër dhe zjarrin mund ta shihnim prej aty. Të them të drejtën, u frikësua shumë. U larguam rreth 15 minuta me makinë dhe qëndruam në një restorant, ujë e duke pritur që situata të qetësohej. Rreth mesnatës komunikuam me hostelin dhe na thanë se ishte në rregull të ktheheshim. Kur u rikthyem, kishte ende prush dhe gjurmë të zjarrit, por flakët ishin më larg. Kishte ikur edhe energjia elektrike dhe ishte shumë vapë, por situata ishte më e mirë. Sot ndihemi mirë. Sigurisht që është ende pak e frikshme kur mendon se zjarri u afrua kaq shumë, por e rëndësishme është që situata tashmë është vënë nën kontroll”, theksoi një tjetër.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Presidenti Begaj perkujton Shenjtoren Nene Tereza: Amanet per te qene prane atyre qe kane me shume nevoje](#)

10:50 Sociale

[Në prag të Ditës së Shën Terezës, Bashkia e Tiranës rigjellbëron sheshin në qendër të kryeqytetit](#)

19:20 Sociale / 6 komente

[Vijon puna për rrugën Elbasan-Rrogozhinë, Rama: Realizimi fizik ka arritur në 87%](#)

15:00 Sociale / 4 komente

Mbidoza, urgjenca që mund të parandalohet, ekspertët apelojnë për ndërhyrje në kohë

14:00 Sociale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.